



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA PUKË

Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit

Nr. 1536 prot.

Pukë, më 27/07/2021.

PROJEKT-VENDIM

Nr. 1, Datë 27/07/2021.

“PËR EMËRTIMIN E NJË QENDRE SHËNDETËSORE NË TERRITORIN E BASHKISË PUKË”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, nën pika 1.7, shkronja “b”, nenit 54, shkronja “ll” dhe nenit 55, pika 2 dhe 6 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”(i ndryshuar); si dhe neni 2 pika 1(ç), neni 3, neni 5 pika 1, neni 7, neni 25, neni 26, të Ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave”(i ndryshuar); Ligjit nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak pasi mori në shqyrtim kërkesën,

VENDOSI:

1. Emërtimin “Shpëtim Gjebrea” të Qendrës Shëndetësore Luf, Njësia Administrative Luf-Qerret, Bashkia Pukë.
2. Çdo vendim i mëparshëm që bie në kundërshtim me pikën 1 të këtij vendimi, shfuqizohet.
3. Ngarkohet Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hy në fuqi sipas përcaktimeve të ligjit nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër.

Hartuesi
Drejtori i Urbanistikës
Alda Mema

Juristi

Igli Trupja

KRYETARI
GJON GJONAJ

Me numërore 8 me parafshirje
Zy. Shqyrtuese
Gjon



**RELACION
PËR
PROJEKT-VENDIMIN “PËR EMËRTIMIN E NJË QENDRE
SHËNDETËSORE NË TERRITORIN E BASHKISË PUKË”**

Nr. 1536/1 Prot

Dt. 27.07.2021

Drejtuar: Këshillit Bashkiak

Të nderuar Këshilltare/Keshilltarë

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) dhe të ligjit nr. 9270/2004 “Për sistemin e adresave” (i ndryshuar), me qëllim emërtimin e institucioneve të pa emërtuara në territorin e Bashkisë Pukë, ku një ndër këto është dhe Qendra Shëndetësore Luf, një objekt i vënë në funksion pas rikonstruksionit kryer nga Ministria e Shëndetësisë për një shërbim bashkëkohor dhe sa më pranë qytetarëve.

Për emërtimin e kësaj qendre shëndetësore, propozohet “Shpëtim Gjebrea”, një mjek i nderuar dhe i vlerësuar për punën disa vjeçare (1958-1964) në shërbim të qytetarëve Pukjanë. Është me rëndësi të madhe, që njerëz të tillë të mos lihen në harresë, por të kujtohen me nder për kontributin, vlerat dhe profesionalizmin e treguar gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre profesionale.

Mjeku Shpëtim Gjebrea ka dhënë një kontribut të madh në ngritjen e spitalit të Pukës dhe me infrastrukturë mbështetëse. Përveç cilësive të larta profesionale, është njohur si një organizator i aftë e drejtues vizionar në fushën e mjekësisë, i cili gëzon titullin “Qytetar Nderi” i Bashkisë Pukë me motivacionin “Për kontribut të shquar me ndërgjegje e përkushtim si mjek në mbrojtje të shëndetit të komunitetit të rrethit të Pukës gjatë viteve 1958-1964” sipas VKB nr. 33 datë 21/05/2019.

Dr. Shpëtim Gjebrea, lindur më 14 Janar 1935 ka mbaruar studimet e larta në vitin 1958 në Fakultetin e Mjekësisë Tiranë.

Nisur nga faktet e sipërcituara kërkojmë nga ana juaj të miratohet projekt-vendimi “Për emërtimin e një qendre shëndetësore në territorin e Bashkisë Pukë”

Ju faleminderit!

**Hartuesi
Drejtori i Urbanistikës
Alda Mema**



**KRYETARI
GJON GJONAJ**

Në mungesë e me porosi
Zs/Kryetare
Ershela GJONI

